REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 801/23
Datë/Datum. 01.11.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr.801/23

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës të Operatorit ekonomik (OE) KOSOVA LIMO FERIZAJ SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Zhvarrosja, transporti, arkivoli, vorrosja, vendosja e gureve me mbishkrime" me numër të prokurimit KEK-23-3646-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. Kryetari i panelit shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit Vedat Poterqoi me datën: 01/11/2023, mori këtë:

V E N D I M

1.Hedhet si e palejuar, ankesa e KOSOVA LIMO FERIZAJ SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0801, e datës 16/10/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit me titull "Zhvarrosja, transporti, arkivoli, vorrosja, vendosja e gureve me mbishkrime", me numër të prokurimit KEK-23-3646-2-2-1, inicuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves sh.a., pasi që operaotri ekonomik konsiderohet si palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.

2. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.04.2023, Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Zhvarrosja, transporti, arkivoli, varrosja, vendosja e gurëve me mbishkrime" me nr. të prokurimit: KEK-23-3646-2-2-1. Me datën 07. 07. 2023 AK ka publikuar vendimin për dhënie të kontratës.

OSHP pas pranimit të ankesave nga OE ankues, ka nxjerr vendimin Nr.2023/0316 me datën 27.06.2023, 2023/0501 dhe 2023/0513 me datën 15.09.2023, ku ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE Eurokod sh.p.k. dhe pjesërisht ankesën e V-SH "Loti" sh.p.k. dhe ka kthyer aktivitetin e prokurimit "Zhvarrosja, transporti, arkivoli, varrosja, vendosja e gurëve me mbishkrime" me nr. të prokurimit: KEK-23-3646-2-2-1, në Rivlersim.

Pas rivlerësimit, me 29.09.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë Eurokod sh.a.

Me 03.10.2023, OE KOSOVA LIMO FERIZAJ SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me 04.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesë për rishqyrtim të OE KOSOVA LIMO FERIZAJ SH.P.K

I pakënaqur me vendimin e lartcekur të AK, me datën 16.10.2023, OE KOSOVA LIMO FERIZAJ SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën me nr.801/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP pas shqyrtimit dhe analizimit të gjithë dokumentacionit të ankesës dhe procedurës se prokurimit në kontekstin shpjegimeve si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, palëve në procedurë u konstatua se ankuesi cilësohet si palë pa interes juridik material, ku nder të tjera vihet në zbatim neni 103 i LPP, sipas të cilit, *"Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 te këtij ligji"*. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e OSHP se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në ketë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4 të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli shqyrtues konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të nenit 111 të LPP dhe për këtë çështje juridike janë dhënë tre vendime me Nr.2023/0316 me datën 27.06.2023, Nr. 2023/0501 dhe 2023/0513 me datën 15.09.2023, me të cilin vendim ka kthyer aktivitetin e prokurimit në fjalë në rivlerësim pasi që ka konstatuar se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, 60 dhe 72 të LPP-së, sepse në shkresat e kësaj lënde vërehet se AK nuk ka zbatuar drejtë dispozitat për prokurim publik në drejtim të operatorëve

ekonomik. Lënda është kthyer në ri-vlerësim duke e bërë OE të rekomanduar nga AK si të papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, sepse nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 dhe 9.2.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP. Ndërsa, autoriteti kontraktues mbanë përgjegjësi të plotë sa i përket respektimit të dispozitave ligjore për prokurimit publik., konform nenit 24, paragrafit 2 të LPP, si dhe dispozitave tjera ligjore.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës se parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.